Kolegë, për shkak të vonesës me postimin e prezentimeve në web-site të Fakultetit Ekonomik (shih prezentimet më poshtë), testi i parë nga lënga Biznes Ndërkombëtar shtyhet për ditën e premte (25 nëntor 2011). Për detajet tjera ju informoj të mërkuren gjatë mësimit të rregullt.

Mësimdhënësi i lëndës,

Dr. Petrit Gashi

Biznesi ndërkombëtar dhe globalizimi

Fakulteti Ekonomik, UP
Biznes Ndërkombëtar

Përmbajtja e prezentimit

- Biznesi ndërkombëtar:
  - Cili është objekti i studimit të biznesit ndërkombëtar?
  - Pse angazhohen firmat në biznesin ndërkombëtar?
  - Cilët janë faktorët e rritjes së biznesit ndër. sot?
  - Cilat janë mënyrat e angazhimit në biznesin ndërkombëtar?
- Globalizimi:
  - Koncepte kyçe;
  - Institucionet globale;
  - Faktorët nxitës të globalizimit;
  - Argumentet për dhe kundër globalizimit.

Objekti i biznesit ndërkombëtar

- Krijimi i tregut global apo globalizimi;
- Rrethina (politike, ekonomike, sociale, kultura);
- Mënyrat e depërtimit në treg (eksporti, nën-kontraktuesit, investimet, licencimi, franshiza, aleancat strategjike, etj.)
- Çështjet tjera brenda firmës, si strategjia, organizimi, aktivitetet, R&D, kapitali human, etj

Arsyet e angazhimit të firmave në biznesin ndërkombëtar

- Të zgjerojnë shitjet apo tregun;
- Të gjejnë burime (kapital dhe teknologji);
- Të diversifikojnë burimet për shitjet dhe furnizimet;

Faktorët përcaktues të rritjes dhe mënyrat e angazhimit në biznesit ndërkombëtar

- Faktorët:
  - Zhvillimi teknologjik;
  - Liberalizimi i tregut botëror;
    - Zhvillimi i institucioneve për të mbështetur dhe lehtësuar tregtinë ndërkombëtare;
  - Rritja e konkurencës globale.
- Mënyrat:
  - Eksporti, nën-kontraktuesit, investimet, licencimi, franshiza, aleancat strategjike, etj.

Globalizimi

- Globalizimi i referohet tendencave drejt një ekonomie globale më të integruar dhe të ndërvarur;
  - …ekonomitë botërore po lëvizin nga sistemet relativisht të izoluara nga kufizimiet/barrierat në tregti dhe investime, pastaj nga distanca, zonat kohore, gjuha, si dhe dallimet në sistemin ligjor e kulturat … në ekonomi të hapura ku barrierat në tregti dhe investime po zvoglohen; distanca po zvoglohet si rezultat i zhvillimeve në teknologji; kultura po njësohet; dhe ekonomitë nacionale janë duke u shkrirë në ekonomi të ndërvarura dhe integruara, duke krijuar kështu një sistem unik global.

Globalizimi (vazh.)

- Globalizimi i tregjeve → bashkimi dhe unifikimi i tregjeve nacionale historikisht të ndryshme në një treg të madh global;
  - Dallimet prezente, edhe pse tendencat drejt unifikimit janë evidente, si në shije të konsumatorëve, kanaleve të distribuimit, sistemin e vlerave (kulturat e ndryshme), sistemet në të cilat operojnë bizneset, e veçanërisht sistemin ligjor.
- Globalizimi i prodhimit → zhvendosja e prodhimit në lokacione me kosto më të ulët dhe kualitet më të lartë të faktorëve të prodhimit;
  - Synim gjithashtu edhe zgjerimi i tregut.

Institucionet globale

- ↑ e globalizimit të tregjeve e të prodhimit ↑ nevojën për institucione formale të cilat do ta menaxhojnë, rregullojnë, mbikqyrin tregun global, si dhe të promovojnë marrëveshje multilaterale me qëllim të funksionimit të sistemit global të biznesit.
  - Marëveshja e Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT); nga 1994 Organizata Botërore e Tregtisë (WTO)
    - Funksioni: mbikqyrja e sistemit botëror të tregtisë;
      - Objektivë: ulja e barrierave për tregti dhe investime.

Institucionet globale (vazh.)

- Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF)
  - Funksioni: mbajtja në vijë e sitemit monetar ndërkombëtar.
    - Huadhënës i fundit për qeveritë në telashe (lender of last resort).
- Banka Botërore (WB)
  - Funksioni: zhvillimi ekonomik
    - Huadhënie për projektet në infrastrukturë.
- Kombet e Bashkuara (UN)
  - Sigurimi i paqës përmes bashkëpunimit ndërkombëtar si dhe sigurisë kolektive.

Faktorët nxitës të globalizimit

1. Zvoglimi i barrierave në qarkullimin e lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit;
   - GATT/WTO: 8 runde negociatash
     - Rundi i fundit i Dohas;
       - Agjenda: ulja e tarifave në produkte industriale, shërbime, dhe produkte bujqësore; zvoglimi i subvencioneve në prod. bujqësore, zvoglimi i barrierave në investime (veçanërisht *cross-border*), dhe limitimi i shfrytezimit të ligjit antidamping.
2. Ndryshimet teknologjike, sidomos në teknologji komunikimi, përpunim informatash, dhe teknologji transporti;

Faktorët nxitës të globalizimit (vazh.)

- Implikimet në **prodhimin global**;
  - ↓ shpenzimet transportit → shpërndarja gjeografike e prodhimit u bë më ekonomike;
  - ↑ inovacionet teknologjike (të përfolura më lart), shpenzimet reale të informacioneve ↓, gjë që mundësoi krijimin dhe menaxhimin e lehtë të sistemeve prodhuese të shpërndara gjeografikisht.
- Implikimet në **tregun global**;
  - ↑ inovacionet teknologjike → rrjete komunikuese globale të lira (psh. 'www') → tregje globale elektronike.
  - ↓ shpenzimet transportit → kosto më të ulta për transportin e produkteve/shërbimeve, duke lehtësuar krijimin e tregjeve globale.

Debati mbi globalizimin

- Globalizimi dhe vendet e punës:
  - **Kundër**: ↓ i barrierave në tregti/investime shkakton ↓ e vendeve të punës në sektorin prodhues në vendet e avancuara;
    - ↓ i barrierave në tregti/investime u mundëson kompanive të zhvendosin aktivitetet në vende me kosto më të ulët (sidomos paga më të ulta);
      - Këto kompani 'eksportojnë vende pune', duke rritur papunësinë dhe ulur standardin jetësor.
  - **Për**: Tregtia e lirë (liberalizimi i tregtisë) do t'u mundësojë shteteve të specializohen në prodhimin produkteve dhe shërbimeve në të cilat kanë përparësi krahasuese;
    - Kur një ekonomi i përkushtohet liberalizimit të tregtisë, me siguri se do të ketë dislokim të aktivitetit ekonomik që nuk do t'i përgjigjet sicilit sektor të ekonomisë mirëpo ekonomia në tërësi do të përfitojë.

Debati mbi globalizimin (vazh.)

- Globalizimi – politikat e punës – ambienti;
  - **Kundër:** Zhvendosja e aktivitetit ekonomik në vendet me kosto të ulët të prodhimit bëhet me qëllim të përfitimit nga mungesa/(mos-zbatimi) e ligjit për të mbrojtur punëtorët si dhe ambientin;
    - Aplikimi i standardeve strikte të punës dhe ruajtja a ambientit rrit koston e firmës.
  - **Për:** mbrojtja e punëtorëve dhe ambientit është në raport të drejtë me zhvillimin ekonomik të një vendi

    → Meqenëse tregtia e lirë ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike të një vendi

    → Zhvillimi ekonomik i një vendi do të ndikonte në zbatimin e rregullave më strikte në vendin e punës dhe mbrojtjen e ambientit

    → Andaj, përfundimisht, tregtia e lirë ndikon në mbrojtje më të madhe të punëtorëve si dhe ndotje më të vogël të ambientit.

Debati mbi globalizimin (vazh.)

- Humbja e sovranitetit të vendit:
  - **Kundër:** fuqia e qeverive nacionale po bie vazhdimisht dhe një pjesë të kompetencave të tyre po transferohen të organizatat si UN, WTO, EU, etj.
  - **Për:** këto institucione janë të krijuara për realizimin e interesave kolektive (pra, të anëtarëve të tyre);
    - Fuqia e tyre është e limituar nga ajo çfarë pajtohen vet qeveritë nacionale të vendeve.

      → si rezultat, fuqia qëndrore mbetet me qeveritë nacionale e jo me organizatat supranacionale.

Teoritë e tregtisë ndërkombëtare

Fakulteti Ekonomik, UP

Biznes Ndërkombëtar

Sot…

- Teoritë e tregtisë ndërkombëtare:
  - Adam Smith: Teoria e Përparësive Absolute;
  - David Ricardo: Teoria e Përparësive Krahasuese;
  - Teoria Heckscher-Ohlin;
  - Teoria e bazuar në Ciklin Jetësor të Produktit;
  - Teoria e Re e Tregtisë;
  - Michael Porter: Teoria e Përparësive Konkuruese Nacionale

Teoria e Përparësive Absolute [1]

- Adam Smith (*Wealth of Nations*, 1776):
  - Një vend ka përparësi absolute në prodhimin e një produkti kur është më efiçient se çdo vend tjetër i cili e prodhon të njëjtin produkt;
    - Vendi duhet të eksportojë ato produkte në të cilat ka përparësi absolute e të importojë ato produkte në prodhimin e të cilave është më pak efiçient se vendet tjera

Shembull:

	SHBA	UK
Gruri (thasë/orë)	6	1
Pëlhura (metra/orë)	4	5

Teoria e Përparësive Absolute [1]

- SHBA-të përparësi absolute dhe specializohen në prodhimin e grurit;
- UK përparësi absolute dhe specializohet në prodhimin e pëlhurës;
- E para teori e bazuar në tregtinë e lirë;
  - 'Dora e fshehur', e jo qeveria, përcakton atë se çfarë importohet dhe eksportohet;
- Kjo teori nuk tregon se çfarë do të ndodhë me vendin i cili ka përparësi absolute në prodhimin e të gjitha produkteve;
  - Ky vend nuk do të përfitonte nga tregtia e jashtme;
  - Teoria e Përparësive Komparative e Rikardos dhe ajo Heckscher-Ohlin janë në të njëjtën vijë me Smithin dhe sqarojnë dilemen e shtruar më parë;

Teoria e Përparësive Krahasuese [1]

- Rikardo (*Principles of Political Economy*, 1817):
  - …një vend duhet të specializohet në prodhimin e atyre produkteve të cilat i prodhon me efiçiencën më të madhe dhe të importojë ato produkte në prodhimin e të cilave është më pak efiçient edhe nëse kjo do të thotë të blejë të mira nga vendet tjera të cilat do të mund t'i prodhonte vet në mënyrë me efiçente në krahasim me to.
  - … përparësitë krahasuese arrihen bazuar në differencat në nivelin e produktivitetit;
  - Bazohet në logjikën e tregut të lirë;

Teoria e Përparësive Krahasuese [2]

Shembull:

	SHBA	UK
Gruri (thasë/orë)	6	1
Pëlhura (metra/orë)	4	2

- SHBA-të kanë përparësi absolute në prodhimin e të dyja produkteve;
- SHBA-të përparësi më të madhe krahasuese dhe specializohen në prodhimin e grurit (raporti 6:1 krahasuar me 4:2);
- UK-ja disavantazh më të vogël krahasues dhe specializohet në prodhimin e pëlhurës (raporti 2:4 krahasuar me 1:6).

Heckscher-Ohlin (1919 & 1933):

- … përparësitë krahasuese të një vendi varen nga ajo se sa ai vend është i pasur me faktorë të prodhimit (veçanërisht me burime natyrore);
  - Bazohet në logjikën e tregut të lirë;
  - Vendi do të eksportoje produkte intenzive në ato pasuri të cilat i posedon dhe importojë ato produkte që janë intensive në faktorët të cilët nuk i posedon.

Teoritë e tjera të tregtisë ndërkombëtare [1]

- Raymond Vernon – Cikli Jetësor i Produktit (1966):
  - … heret në fillim produkti prodhohet dhe eksportohet nga vendi i cili e ka shpikur, dhe kur produkti pranohet ndërkombëtarisht, prodhimi i tij fillon edhe në vende tjera. Përfundimisht, sikur sygjerohet nga teoria, i njëjti produkt mund të importohet nga vendi ku është shpikur.

Teoritë e tjera të tregtisë ndërkombëtare [2]

- Paul Krugman – Teoria e Re e Tregtisë (1970-tat dhe 80-tat):
  - Bazohet në arritjen e ekonomive të shkallës nga firmat;
    - Përmes ndikimit të ekonomive të shkallës, tregtia mund të rrisë llojllojshmërinë e produkteve në treg dhe uljen e shpenzimeve mesatare të këtyre produkteve;
      - Modelimi i ekonomive jo-konstante të shkallës dhe konkurencës monopolistike nga Stiglitz & Dixit në 1979;

Diamanti i Porter-it si sistem



Diskutim

Identifikoni cilët janë sektorët të cilët kanë potencial për eksport në Kosovë dhe përshkruani këmbimet e këtyre sektorëve me botën e jashtme në kontekst të teorive të diskutuara.

Dallimet në ekonominë politike dhe ndikimi i tyre në biznesin ndërkombëtar

Fakulteti Ekonomik, UP

Biznes Ndërkombëtar

Hyrje

- Dallimet në biznesin ndërkombëtar nga ai vendor;
- Sistemet politike, ekonomike, dhe legale;
- Dallimet në zhvillimin ekonomik;
- Dallimet dhe implikimet e tyre në BN: përfitimet, kostot, dhe risku.

Biznesi vendor vs. ndërkombëtar

- Dallimet në sistemin politik, ekonomik, legal, edhe në nivelin e zhvillimit ekonomik;
- Kompleksitet më i madh në zhvillimin e biznesit ndërkombëtar;
  - Lokacionin e prodhimit që siguron minimizimin e kostove dhe maksimizimin e vlerës së shtuar; Cilat tregje të hyjnë e cilat t'i evitojnë; konsiderojnë aspektete etike për shfrytëzimin e zbraztirave në ligj (ambient dhe kushtet e punës – diskutuar më parë); të vendosin mbi formën e depërtimit në treg (tregti apo prodhim); etj.
- T'i njohin rregullat me të cilat udhëhiqen tregtia e jashtme dhe investimet;
  - Të konsiderohet edhe mundësia e intervenimit të qeverisë edhe pse kjo e fundit mund të jetë e përkushtuar për liberalizim;
- Biznesi realizohet në vende me valuta të ndryshme;
  - Të konsiderohen ndryshimet konstante në normat e këmbimit.

Sistemet politike [1]

- Sistemet politike definohen sipas dy dimensioneve :
  1. Kolektivizmi vs. individualizmi;
     - Kolektivizmi: nevojat kolektive janë mbi lirinë individuale (Platoni → Marksi);
       - Format: Komunistët & social demokratët.
     - Individualizmi: orientim sipas së cilit individi duhet të jetë i lirë në synimet e tij ekonomike dhe politike (Aristoteli, Mill, Smith);
       - Indvidualizmi është i ndërtuar mbi 2 premisa:
         - Sigurimi i lirive individuale dhe lirisë së shprehurit;
         - Niveli më i lartë i mirëqenies sociale arrihet përmes përmbushjes së synimeve individuale nga vetë individi e jo nga ndonjë organ kolektiv (psh. qeveria) e cila do të diktonte se çfarë është në interesin e përgjithshëm.

Sistemet politike [2]

- Sistemet politike:
  2. Demokracia vs. totalitatizmit;
     - Demokracia: qytetarët janë të përfshirë drejtëpërdrejtë në vendimmarrje;
       - Demokracia ↔ individualizmi;
     - Totalitarizmi
       - Totalitarizmi: të drejtat e garanuara në demokraci janë inekzistente;
       - Format: totalitarizmi komunist; totalitarizmi teokratik (Irani & Arabia Saudite); totalitarizmi fisnor (Zimbabve, Tanzania, Uganda); dhe, totalitarizmi djathtist (Gjermania dhe Italia e viteve 30-të dhe 40-të).

Sistemet ekonomike

- Ekonomia e tregut;
- Ekonomia e komanduar;
- Ekonomitë mikste;

Zhvillimi ekonomik

- Sistemi politik, ekonomik, dhe ai legal → zhvillimi ekonomik i një vendi;
  - BN analizojnë indikatorët (shih: *World Development Indicators në www*):
    - GNI (Gross National Income) – të ardhurat totale të marra nga banorët e një vendi;
      - GNI nuk llogaritë koston e jetësës;
      - Andaj indikatorët llogariten sipas PPP (Purchasing Power Parity);
    - GDP (Gross Domestic Product);
    - Rritja e indikatorëve tregon nivelin e zhvillimit potencial të vendit apo rajonit.
    - Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (*Human Development Index*)

Sistemi ligjor

- Sistemi ligjor: korniza ligjore dhe zbatimi i ligjit;
- Sistemet/praktikat ligjore:

→ Zakonor (*Common Law*) (Britani e Madhe dhe ish kolonitë e saj);

- Bazohet në traditë (apo në historinë ligjore të vendit), praktikat e mëparshme (rastet të cilat janë paraqitur në gjykata), dhe zakon (çfarë vendimi është marrë në rastet të cilat janë paraqitur para gjykatave);
  - Krijon fleksibilitet të madh në vendimmarrje.

→ Civil (*Civil Law*) (mbi 80 vende në botë: Franca, Gjermania, Japonia)

- Bazohet në një numër të madh të ligjeve të detajizuara;

→ Teokratik (*Theocratic Law*) (ligji i bazuar në mësimet Islame; gjatë shekullit 20 edhe ai Hindu dhe Judaik)

- Bazohet në mësimet fetare.

Implikimet e sistemeve të ndryshme ligjore në BN [1]

- Ligji mbi kontratat: varet nga sistemi ligjor i aplikuar në vend;
  - Në sistemin zakonor: shumë i specifikuar;
  - Në sistemin civil: i shkurtë dhe më pak i specifikuar;
    - Në nivel ndërkombëtar, kur sistemet ligjore janë të ndryshme, operon CIGS (*UN Convention on Contracts for the International Sale of Goods*).

Implikimet e sistemeve të ndryshme ligjore në BN [2]

- Të drejtat pronësore (*Property rights*): edhe pse ligjet ekzistojnë, ato nuk mbrohen;
  - … u referohen të drejtave ligjore mbi shfrytëzimin dhe përfitimet e caktuara si rezultat i pronësisë mbi faktorët e prodhimit;
    - Të drejtat pronësore mund të cenohen nga:
      - Aksionet private: hajnitë, piratimi, kërcënimet, dhe të ngjajshme nga individët apo grupet e caktuara;
      - Aksionet publike dhe korrupsioni (shih *Global Corruption Report*);
        - …kur zyrtarët (psh. qeveritarët) përfitojnë të ardhura, resurse, apo pronë nga pronarët;
        - …duke vendosur tatime më të larta, kërkuar licenca të shtrenjta, nacionalizimi (apo redistribuimi) i aseteve pa kompenzim;
        - Kjo arrihet përmes mjeteve jo-ligjore, korrupsionit, mitos, etj.

Implikimet e sistemeve të ndryshme ligjore në BN [3]

- Mbrojta e pronës intelektuale (softuerët kompjuterik, skenari i filmit, këngët, formula kimike për një barnishtë, etj.)
  - Këto ligje janë stimul për inovacione dhe punë kreative;
  - Patentët, të drejtat autoriale (*copyrights)*, dhe marka e produktit (*brand*) vendosin të drejtat pronësore mbi pronën intelektuale.
  - BN: nga 1995 TRIPS (*Trade Related Aspects of Intellectual Property Rights*) brenda WTO-së.
- Siguria e produktit & detyrimet tjera;
  - Ligjet mbi sigurinë e produktit dhe detyrimet kur produkti shkakton lëndime, dëmtime apo vdekje;
    - Ekzistojnë ligji civil (që kërkon kompenzim monetar për dëmtimin) dhe ai kriminalistik (parasheh pagesë apo edhe burgim për dëmtuesit).

Dallimet në sisteme dhe implikimet e tyre në BN

- Sistemi politik, ekonomik, & ligjor kanë ndikim:
  - Në fitimet, koston, dhe riskun me të cilin ballafaqohen BN;
  - Në mënyrën se si bizneset në vende të ndryshme duhet menaxhuar; dhe,
  - Në strategjinë të cilën duhet ndjekur BN-e.
- Sistemi politik, ekonomik, & ligjor përcakton edhe nivelin e përgjithshëm të atraktivitetit të një vendi për të operuar apo investuar (shih World Bank *Doing Business in 2012*).

Dallimet në Kulturë dhe Biznesi Ndërkombëtar

Fakulteti Ekonomik, UP
Biznes Ndërkombëtar

Sot…

- Kultura: specifikat
- Kultura dhe dimensionet e saj

Kultura: specifikat

- Kultura – sistem i vlerave dhe normave të përbashkëta për një grup njerëzish që kur të trajtohen së bashku paraqesin një stil/mënyrë të caktuar të jetës (Hofstede & Namenwirth; Weber);
- Vlerat – ide abstrakte mbi atë se çfarë grupi (shoqëria) mendon se është e mirë, e drejtë, dhe e dëshirueshme;
  - Përfshijnë pikëpamjet e shoqërisë mbi liritë, demoracinë, të vërtetën, sinqeritetin, lojalitetin, përgjegjësitë kolektive, gratë, seksin, martesën, etj.
- Normat – rregulla shoqërore të cilat përcaktojnë një udhëzues të sjelljes së mirë në shoqëri. Normat përcaktojnë rregullat sociale mbi të cilat bazohen raportet midis njerëzve.
  - Mbi bazën e vlerave përcaktohen dhe justifikohen normat.
- Shoqëri – grup individësh të cilët ndajnë vlera dhe norma të përbashkëta.

Kultura dhe dimensionet e saj [1]



Kultura dhe dimensionet e saj [2]

- Struktura sociale i referohet formës së organizimit shoqëror të shoqërisë;
  - 2 dimensionet e strukturës sociale:
    1. Shkalla sa favorizohet individi ndaj grupit;
       - Aty ku favorizohet individi (vendet perendimore) është i sprehur individualizmi dhe ndërmarrësia.
       - Aty ku grupi është fokus (shoqëria tradicionale Japoneze) suksesi sigurohet nga qëllimi i përbashkët (presioni brenda grupit).
    2. Shkalla se sa është e stratifikuar/'kastifikuar' shoqëria;
       - Këto shtresa përcaktohen në bazë të të ardhurave, të kaluarës së familjes, dhe profesionit.

Kultura dhe dimensionet e saj [3]

- Religjioni përcakton sistemin e etikës (kryesisht);
  - Etika grup principesh morale apo vlerash mbi të cilat përcaktohen sjelljet;
  - (shih Barro & McCleary, 2003)


ARCTIC OCEAN
Arctic Circle
NORTH PACIFIC OCEAN
NORTH ATLANTIC OCEAN
PACIFIC OCEAN
Tropic of Cancer
Equator
Tropic of Capricorn
INDIAN OCEAN
SOUTH PACIFIC OCEAN
SOUTH ATLANTIC OCEAN
Antarctic Circle
Christianity
Mostly Roman Catholic
Mostly Protestant
Mostly Eastern Orthodox
Islam
Sunni
Shia
Hinduism
Judaism
Buddhism
Chinese Religions
Shinto and Buddhism
Traditional and Tribal
Tribal and Christian
Tribal, Christian and Muslim
0 1000 2000 Miles
0 1000 2000 3000 Kilometers


Christianity
33%
Islam
20%
No religion
15%
Hinduism
13%
Buddhism
6%
Atheists
4%
Chinese folk rel.
4%
New Asian rel.
2%
Tribal Religions
2%
Other
<1%
Sikhism
<1%
Judaism
<1%
Shamanists
<1%
Spiritism
<1%
Confucianism
<1%
Baha'i Faith
<1%
Jainism
<1%
Shinto
<1%
Zoroastrianism
<1%

Kultura dhe dimensionet e saj [4]

- Gjuha ndihmon në definimin e kulturës;
  - Vendet me shumë gjuhë janë vende me shumë kultura;
  - Gjuha e folur dhe me shenja;

Kultura dhe dimensionet e saj [5]

- Fakte mbi gjuhët botërore (nga National Geographic):
  - Në vitin 2007 janë folur 6,912 gjuhë të ndryshme;
  - 83 gjuhë (përfshirë këtu gjuhën mandarine, spanjishtën, anglishtën, dhe gjuhën hindu) dominojnë në tërë botën me 80% të pupullsisë;
  - Më tepër se gjysma e gjuhëve të botës flitet nga më pak se 1% e popullsisë së botës;
  - Më pak se 3000 vetë e flasin gjuhën Urarina në Amazon; Halkomelem flitet nga 200 banorë në Kanadë; Tofa flitet vetëm nga 25 njerëz në Siberi;
  - Linguistët parashohin se deri në fund të shek. 21 vetëm gjysma e gjuhëve që sot fliten mund të fliten edhe atëherë;
  - Shkencëtarët vlerësojnë se që nga viti 1600, nga planeti janë zhdukur rreth 1,200 bimë dhe shtazë të njohura (që përbënë 7% të totalit).
  - Sot llogatiten 40% të gjuhëve në rrezik të zhduken si rezultat i globalizimit.

Languages of the World



Bilingual Dictionaries | Vocabulary Lessons | Language Quizzes | Language Games | www.bab.la

babLa
Loving Languages

Source: babla, primarily based on various national census data & Eurobarometer. © babla 2005. Reproduction permitted under Creative Commons License 3.0 (Germany).

Kultura dhe dimensionet e saj [6]

- Edukimi → determinantë e përparësive krahasuese nacionale (Michael Porter);
  - Edukimi faktor i rëndësishëm në zgjedhjen e lokacionit të biznesit ndërkombëtar;
    - Procesi i aglomerimit/lokalizimit/klasterëve;
      - Fuqia punëtore e edukuar dhe e koncentruar në hapsirë të caktuar.
  - Edukimi përcakton kulturën në vendin e punës;

Politika Ekonomike në Tregtinë Ndërkombëtare

Biznes Ndërkombëtar

Fakulteti Ekonomik, UP

Hyrje

- Klasikët dhe roli i qeverisë në tregtinë ndërkombëtare;
- Intervenimet e qeverisë në tregtinë ndërkombëtare;
- Integrimi ekonomik rajonal.

Smith, Rikardo, dhe Heckscher-Ohlin:

LIBERALIZIMI I TREGTISË

Instrumentet e politikës tregtare [1]

- Instumentet tarifore:
  - Tatimet në importe;
    - Llojet: specifike (ngarkesë fikse për produktin e importuar) & bazuar në vlerë;
    - Përfituesit: qeveria & prodhuesit;
    - Humbësit: konsumatorët;

Instrumentet e politikës tregtare [2]

- Instrumentet jo-tarifore:
  - Definimi (Deardorff dhe Stern, 1997, f. 4):

    Vështirësia elementare në përkufizimin e BJT është se ato janë të definuara me atë çfarë nuk janë. BJT janë pengesa të natyrës jo-tarifore. Madje definimi i tyre është edhe më i përgjithshëm se aq, sepse ky term përdoret për të përfshirë edhe intervenimet në politikën tregtare siç janë subvencionet që shërbejnë për të stimuluar dhe jo për të zbrapsur tregtinë, andaj edhe logjikisht nuk mund të konsiderohen si 'barriera' në tregti. BJT përfshijnë edhe ato politika dëmtuese të tregtisë siç janë kuotat e importit dhe kufizimet vullnetare të eksportit. Ato përfshijnë gjithashtu një gamë të gjerë politikash potenciale, ndoshta edhe ato që nuk janë aplikuar ende e që ndikojnë në mënyrë indirekte në çmimet dhe/apo sasinë e këmbimit.

Instrumentet jo-tarifore të politikës tregtare [1]

- Subvencionet;
  - Format: huazime në kesh, kredi me kushte të volitshme; lirim nga tatimet, pjesëmarrja e qeverisë në kapitalin e firmës.
  - Qëllimet: (1) kompanitë e vendit të jenë konkurentë me kompanitë importuese; dhe, (2) depërtimi në tregjet e eksportit.
  - Politika Tregtare Strategjike;
    - Subvencionet kanal për të përfituar nga *first-mover advantage*;

Instrumentet jo-tarifore të politikës tregtare [2]

- Kuotat e importit dhe kufizimet voluntere të eksportit;
  - Përzierja në mes të kuotave dhe tatimeve për importe;
- Komponenta vendore në përmbajtjen e produktit dhe kushtëzimet për miks të produkteve;
- Politikat administrative;
- Politikat anti-damping.

Arsyet për intervenimin e qeverisë në tregtinë ndërkombëtare

- Faktorët Politik:
  - Mbrojtja e vendeve të punës dhe e industrive;
  - Siguria nacionale;
  - Kundërveprimi;
  - Mbrojtja e konsumatorëve;
  - Realizimi i qëllimeve të politikës së jashtme;
  - Mbrojtja e drejtave të njeriut
- Faktorët Ekonomik:
  - Mbrojtja e industrive që janë në fazën iniciale të zhvillimit;
    - E arsyeshme edhe sipas GATT/WTO
  - Politika Tregtare Strategjike;

Integrimi rajonal dhe nivelet e integrimit [1]

- Integrimi ekonomik rajonal: marrëveshje mes vendeve në një rajon gjeografik me qëllim të zvoglimit apo eliminimit të barierave tarifore dhe jo-tarifore në qarkullimin e produkteve, shërbimeve, dhe faktorëve të prodhimit;
- Nivelet e integrimit rajonal:
  1. Marveshjet e tregtisë së lirë (FTA) – eliminon barierat tregtare në mes të vendeve;
     - European Free Trade Association (EFTA). Sot anëtarë Norvegjia, Islanda, Lihtenshtajni, dhe Zvicrra.
  2. Union doganor – vendet heqin barierat tregtare dhe aplikojnë politikë tregtare të përbashkët;
     - Pakti i Andeve (Bolivia, Ekuadori, Peru, dhe Kolumbia)

Integrimi rajonal dhe nivelet e integrimit [2]

4. Tregu i përbashkët - vendet heqin barierat tregtare, aplikojnë politikë tregtare të përbashkët, dhe lejojnë lëvizjen e lirë të faktorëve të prodhimit;
   - Për shumë vite BE, ndërsa tani ka lëvizur në drejtim të integrimit edhe më të thellë;
   - MERCOSUR (Argjentina, Brazili, Paraguaji, dhe Uruguaji)
5. Unioni ekonomik – përfshinë lëvizjen e lirë të faktorëve të prodhimit, aplikimin e politikës tregtare të përbashkët, si dhe valutën e përbashkët, harmonizimin e sistemit tatimor, dhe politikë të përbashkër monetare;
   - Bashkimi European edhe pse shume vende nuk kanë aplikuar valutën e përbashkët, si dhe sistemi tatimor mbetet i ndryshëm në vendet anëtare;
6. Unioni politik;
   - BE-ja pjesërisht;
     - Parlamenti European nga 1970.

Faktorët pro dhe kundër integrimit rajonal

- Argumentet pro integrimit:
  - Argumentet ekonomike bazohen në faktin se tregtia e lirë u mundëson vendeve të specializohen në prodhimin e produkteve dhe shërbimeve në të cilat kanë përparësi komparative;
  - Argumentet politike janë të lidhura me zbutjen e animoziteteve në mes të vendeve;
- Argumentet kundër integrimit:
  - Industritë mund të ndikohen negativisht nga tregtia e lirë;
  - Humbja e sovranitetit të vendit.

Operacionet e bizneseve ndërkombëtare

Biznes Ndërkombëtar
Fakulteti Ekonomik, UP

Hyrje

- Strategjitë e depërtimit në tregjet;
  - Vendimet rreth hyrjes në tregjet e huaja;
  - Format e depërtimit në tregjet e huaja;
  - Aleancat strategjike.

Vendimet kryesore rreth hyrjes në tregjet e huaja [1]

1. Në cilat tregje të depërtohet;
   - Varet nga potenciali afatgjatë i atij tregu për të gjeneruar fitim;
     - Fitimi është funksion i [a] madhësisë të tregut; [b] pasurisë (fuqisë blerëse) së konsumatorëve; [c] potenciali i rritjes së kësaj pasurie të konsumatorëve (që varet nga rritja ekonomike);
2. Momenti i hyrjes në tregun e huaj;
   - Firma që depërton si e para në treg gjeneron përfitimet në kuadër të konceptit *first-mover advantage*;
   - Depërtimi i hershëm në treg i ka rreziqet e veta;
     - Shpenzimet fillestare (*pioneering costs*); kostot për të mësuar 'rregullat e lojës', edukimi i konsumatorëve, etj.

Vendimet kryesore rreth hyrjes në tregjet e huaja [2]

3. Në çfarë shkalle të depërtohet në treg;
   - Depërtim rapid apo i fuqishëm; tregon për përkushtim strategjik afatgjatë të firmës në atë treg;
     - Firma duhet t'i konsirderojë rreziqet dhe inercionin (mungesën e fleksibilitetit) që është e lidhur me depërtimin rapid të tregje të huaja;
   - Depërtim në shakallë të ultë;
     - Kjo shërben si fazë para depërtimit rapid/masiv në tregun e huaj;
     - Kjo qasje i mundëson kompanisë t'i mësojë 'teket' e tregut dhe të informohet mbi të para se të marrë vendime për zgjerim të mëtutjeshëm;

Format e depërtimit në tregjet e huaja [1]

1. Eksporti;
   - Përparsitë: [a] kosto e ultë për depërtim në tregun e huaj; [b] rreziku më i ultë për t'u ndikuar firma në rast të dështimit;
   - Mangësitë: [a] barrierat e ndryshme tarifore dhe jo-tarifore prezente; [b] shpenzimet e transportit;

Format e depërtimit në tregjet e huaja [2]

2. Projektet "çelsi n'dorë" (*turnkey projects*) – kontraktori obligohet t'i kryej të gjitha aspektet e projektit për klientin, përfshirë këtu edhe trajnimin e personelit operues;
   - Mënyrë për të eksportuar teknologjinë e procesit në vendet e huaja;
   - Aplikohet në vendet ku depërtimi i IJD-ve është i kufizuar;
   - Prezente në industritë e rafinimit kimik, naftës, metalike, farmaceutike, industri ku investimet janë të mëdha;
   - Përparsitë: [a] mënyrë për të përfituar nga teknologjia e procesit; [b] rreziku më i ultë se për IJD-të;
   - Mangësitë: [a] mundësia që firma e cila e realizon projektit t'ia krijojë vetes konkurencën; [b] nëse ajo çfarë ofron firma në formë të '*turnkey project*' është përparësi kompetitive e firmës atëherë kjo do të thotë se është duke ia shitur të njëjtën konkurencës.

Format e depërtimit në tregjet e huaja [3]

3. Licencimi – i jepen të drejtat një kompanie për shfrytëzimin e patentit, invencionit, procesit, dizajnit, të drejtave autoriale, *trademarks*, etj.;
   - Përparsitë: [a] shpenzimet dhe kostot e ulta;
   - Mangësitë: [a] kompania qe e jep licencën nuk ka kontroll të fuqishëm mbi atë që e merr; [b] mund të krijojë konkurencë;

Format e depërtimit në tregjet e huaja [4]

4. Franshiza – e ngjashme me licencimin mirëpo aplikohet në projekte më afatgjata;
   - Në këtë rast franshizori përveç që ofron atë çfarë ofron përmes licencës ajo përcakton edhe mënyrën e bërjes së biznesit;
   - Licencimi në prodhim; franshiza në shërbime;
   - Përparsitë dhe mangësitë të ngjashme me licencimin, por jo edhe aq te shprehura sa në rastin e licencimit;

Format e depërtimit në tregjet e huaja (vazh.)

5. Investimet e përbashkëta;
   - Përparsitë: [a] firma investuese përfiton nga njohuritë që ka firma vendore për atë treg; [b] shpenzimet ndahen në mes të partnerëve;
   - Mangësitë: [a] firma që investon rrezikon dhënien e teknologjisë të vet; [b] mungësë e kontrollit të mjaftueshëm; [c] konfliktet e mundshme në mes të partnerëve rreth qëllimeve dhe prioriteteve të firmës;
6. Investimi 100%;
   - Kjo mund të realizohet përmes: [a] *greenfield investment*, apo [b] duke e blerë një kompani ekzistuese;
   - Përparsitë janë të lidhura me kontrollin dhe fitimin, ndërsa mangësitë janë të lidhura me rreziku e madh që në këtë rast bartet dhe kostot;

Alenacat strategjike

- Alenacat strategjike kanë të bëjnë me marrveshjet që lidhen në mes të konkurentëve ekzistues apo atyre potencial;
  - Suksesi i alencave strategjike varet nga faktorët në vijim:
    - **Zgjedhja e partnerit** me të cilin duhet ndarë vizionin, të synojnë qëllime të njëjta strategjike, dhe të mos jetë oportunist;
    - **Struktura e aleancës** – do të duhej të evitonte oportunizmin, marrjen e teknologjisë dhe know-how, etj.
    - **Menaxhimit i aleancës** – do duhej krijuar raporte interpersonale midis menaxhmentit të firmave që hyjnë në raporte të tilla;
  - Përparsitë: [a] aleancat e tilla mund të lehtësojnë depërtimin në treg; [b] ndarjen e kostove fikse në krijimin e produkteve të reja; [c] aleancat mundësojnë komplementaritet në njohuri;
  - Mangësitë: [a] mundësi për konkurencën të përvetësojë teknologjinë dhe tregjet;